



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E POSAÇME E SHKALLËS SË PARË
PËR KORRUPSIONIN DHE KRIMIN E ORGANIZUAR

NJOFTIM PËR MEDIAT

1. Kërkuesi **Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar** me datë **11.02.2025** ka paraqitur pranë Gjykatës kërkesën me objekt: “1. Marrjen në pyetje dhe verifikimin e kushteve të zbatimit të masës së sigurimit dhe nevojat e sigurimit personal të vendosur për personat nën hetim **Erion Vliaj, Ajola Xoxa, Elman Abule, Gentjan Sula, Meriman Palushi, Fatmir Bektashi dhe Shkëlqim Fusha** me vendimin Nr. 7 Akti, datë 09.02.2025, të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar; 2. Vazhdimin e zbatimit të masës së sigurimit me karakter shtrengues të vendosur ndaj këtyre shtetasve”.

2. Në përfundim të gjykimit, Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar me trup gjykues të përbërë nga gjyqtari Erjon Bani, bazuar në nenet 112, 248 dhe 260 të K.Pr.Penale, me vendimin Nr. **14**, datë **12.02.2025**, vendosi:

1. Vazhdimin e masës së sigurimit “**Arrest në burg**” parashikuar nga neni 238 i K.Pr.Penale, caktuar ndaj personit nën hetim **Erion Vliaj** me vendimin Nr. 7, datë 09.02.2025 të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.
2. Zëvendësimin e masës së sigurimit personal “**Arrest në shtëpi**” caktuar ndaj personit nën hetim **Ajola Xoxa** me vendimin Nr. 7, datë 09.02.2025 të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, me masën e sigurimit personal “**Ndalimi i daljes jashtë shtetit**” dhe “**Detyrim për t’u paraqitur në policinë gjyqësore**” parashikuar nga nenet 233 dhe 234 i K.Pr.Penale.
3. Urdhërohet personi nën hetim **Ajola Xoxa** që të paraqitet para oficerëve të policisë gjyqësore A.H, S.G, R.N dhe B.K, **të Premten e parë dhe të tretë të çdo muaj, ora 11:00.**
4. Urdhërohet personi nën hetim **Ajola Xoxa** të mos largohet nga territori i Republikës së Shqipërisë pa autorizimin e gjykatës, në referim të nenit 233 pika 1 të K.Pr.Penale “**Ndalimi i daljes jashtë shtetit**”.
5. Ndalohet përdorimi i pasaportës dhe dokumenteve të tjerë identifikues të vlefshme për daljen jashtë shtetit, për personin nën hetim **Ajola Xoxa**.
6. Vazhdimin e masës së sigurimit “**Arrest në burg**” parashikuar nga neni 238 i K.Pr.Penale, caktuar ndaj personit nën hetim **Elman Abule** me vendimin Nr. 7, datë 09.02.2025 të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe

Krimin e Organizuar.

7. Vazhdimin e masës së sigurimit “*Detyrim për t’u paraqitur në policinë gjyqësore*” parashikuar nga neni 234 i K.Pr.Penale, caktuar ndaj personit nën hetim **Gentjan Sula** me vendimin Nr. 7, datë 09.02.2025 të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, me këtë ndryshim:
8. Urdhërohet personi nën hetim **Gentjan Sula** që të paraqitet para oficerëve të policisë gjyqësore A.H, S.G, Z. R.N dhe B.K, **të Premten e parë dhe të katërt të çdo muaj, ora 14:00.**
9. Vazhdimin e masës së sigurimit “*Detyrim për t’u paraqitur në policinë gjyqësore*” parashikuar nga neni 234 i K.Pr.Penale, caktuar ndaj personit nën hetim **Meriman Palushi** me vendimin Nr. 7, datë 09.02.2025 të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, me këtë ndryshim:
10. Urdhërohet personi nën hetim **Meriman Palushi** që të paraqitet para oficerëve të policisë gjyqësore A.H, S.G, Z. R.N dhe B.K, **të Premten e parë dhe të katërt të çdo muaj, ora 14:30.**
11. Vazhdimin e masës së sigurimit “*Detyrim për t’u paraqitur në policinë gjyqësore*” parashikuar nga neni 234 i K.Pr.Penale, caktuar ndaj personit nën hetim **Fatmir Bektashi** me vendimin Nr. 7, datë 09.02.2025 të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, me këtë ndryshim:
12. Urdhërohet personi nën hetim **Fatmir Bektashi** që të paraqitet para oficerëve të policisë gjyqësore A.H, S.G, Z. R.N dhe B.K, **të Premten e parë dhe të tretë të çdo muaj, ora 11:15.**
13. Vazhdimin e masës së sigurimit “*Detyrim për t’u paraqitur në policinë gjyqësore*” parashikuar nga neni 234 i K.Pr.Penale, caktuar ndaj personit nën hetim **Shkëlqim Fusha** me vendimin Nr. 7, datë 09.02.2025 të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, me këtë ndryshim:
14. Urdhërohet personi nën hetim **Shkëlqim Fusha** që të paraqitet para oficerëve të policisë gjyqësore A.H, S.G, R.N dhe B.K, **të Enjten e parë dhe të katërt të çdo muaj, ora 14:30.**
15. Ngarkohet Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar në bashkëpunim me policinë gjyqësore për ekzekutimin e këtij vendimi.
16. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar brenda **5 (pesë) ditëve**, duke filluar ky afat nga e nesërmja e njoftimit të këtij vendimi.

Tiranë, më datë 12.02.2025

Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar